



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA E PROJEKTIMIT DHE INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 3315 Prot

Gramsh nr. 01.09.2023

**RELACION TEKNIK**

“PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE ”

BASHKIA GRAMSH”

Ky projekt parashikon rikonstruksionin e pjesshëm të banesave ekzistuese të 12 familjeve, të përqëndruar në territorin e Njësisë Administrative Pishaj, Tunjë, Skenderbegas, Kushovë dhe Kodovjat.

Për pjesën më të madhe të këtyre banesave, nevoja për financim për rikonstruksionin e tyre është më e madhe se fondi i përcaktuar dhe nisur nga kjo ( në bashkërendim me banorët), projekti ynë parashikon kryerjen e punimeve që banorët nuk mund t'i realizojnë vetë, siç janë ndërtimi i çatave të reja, tavaneve, rikonstruksione të brendshme si suvatimet, vendosje dyer dritare, punimet elektrike dhe hidrosanitare.

Në përgjithësi ndërhyrjet parashikojnë rehabilitimin e banesave ekzistuese të cilat paraqiten si tepër të amortizuara .

**1. Gjëndja aktuale:**

Banesat ku jetojnë këto familje janë objekte të vjetra, një katëshe dhe në gjendje tepër të amortizuar.

Ndërtesat janë të ndërtuara në përgjithësi me mure guri me gjerësi 50 – 60 cm .

Çatitë janë me kapriata druri të mbuluar me rrasa guri, tjen qulla vendi tepër të amortizuara ose me materiale të tjera, eternite, letër katrama, plastmas, llamarina etj.

Shtresat e plashemeve janë me llustër çimento, pllaka të copëtuara osë tokë e fortë.

Dyert dhe dritaret janë prej lëndë druri, kompesaë ose lëndë plastike.

Suvatimet kanë humbur funksionin e tyre prej lagështisë së theksuar dhe në raste të caktuara mungojnë fare.

Të gjithë elementet e çati dhe tavanet janë tepër të amortizuara dhe kanë nevojë emergjente për ndërhyrje.


Nëpërmjet këtij projekti realizohet rikonstrukcioni i 12 banesave duke u siguruar banorëve kushte më të mira jetese. Realizimi i këtij financimi u jep mundësinë banorëve që në të ardhmen të kryejnë pjesë pjesë punimet e tjera të nevojshme, duke bërë që banesa të jetë në funksion të plotë.

Përshkrimi dhe fotot e gjendjes aktuale të banesave :

#### 1. Ali Kotorri, fshati Kotorr, Njësia Administrative Pishaj

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri me llaç balte, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane me resë kallami, DysHEMEJA e objektit është prej dërrase, si dhe dyert e dritaret janë prej lënde druri.





## 2. Safet Mema, fshati Gramsh – Fshat, Njësia Adminsitrative Pishaj

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstruksion mur guri me llaç balte, me çati të mbuluar me tjegulla marsejeze, si dhe tavane me fiber plastike, Dyshemeja e objektit është shtruar me pllaka greiz importi, si dhe dyert e dritaret janë prej duralumini.





### **3. Xhevahir Mema, fshati Gramsh – Fshat, Njësia Administrative Pishaj**

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri me llaç balte, i kufizuar me banesën e shtetasit Nuredin Mema. Çatia e kësaj banese është e mbuluar me tjegulla vendi, si dhe tavane me resë kallami. Dyshemeja e objektit është shtruar me pllaka greiz importi si dhe dyert e dritaret janë prej lende druri.



#### **4. Feim Bæci, fshati Bersnik Poshtë, Njësi Administrative Kodovjat**

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990 me konstruksion mur qalle, me çati të mbuluar me tjegulla marsejeze, si dhe tavane pjesërisht me resë kallami e pjesërisht me fiber plastike. Dyshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritarët janë prej druri.



## 5. Veli Shahini, Ishati Bersnik Poshtë, Njësia Administrative Kodovjat

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur tulle, me çati të rëmbuluar me tjegulla vendi, si dhe tavane me fiber plastike. Dyshe-neja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



**6. Lytifi Kokonozi, fshati Dumberas, Njësia Administrative Kushovë**

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur çuri, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane me resë kallami. Dyshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.





## 7. Agim Zani, fshati Dumbëris, Njësia Administrative Kushovë

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri, me çati të mbuluar me rrasa gur, si dhe tavane me resë kallami. Dyshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



#### 8. Azbi Cani, fshati Perrenjas, Njësia Administrative Tunjë

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane pjesërisht në resë kallami e pjesërisht me fibër plastike. Dysheueja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



## 9. Xhezo Dollenga, fshati Plepas, Njësia Administrative Tunjë

Ky objekt është ndërtim dyk itësh, i ndërtuar para v.teve 1990, me konstruksion mur guri, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane me resë kallami. Dytshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



#### 10. Nurihan Çohodari, fshati Skenderbegas Njësia Administrative Skenderbegas

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane me resë kallami. Dyshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



### 11. Artimon Leka, fshati Siman, Njësia Administrative Skenderbegas

Ky objekt është ndërtim njëkatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri, me çati të mbuluar me rrasa guri, si dhe tavane me resë kallami. Dyshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



## 12. Bato Zhupani, fshati Kullollas, Njësia Administrative Skenderbeu as

Ky objekt është ndërtim dykatësh, i ndërtuar para viteve 1990, me konstrukcion mur guri, me çati të mbuluar me tjegulla vendi, si dhe tavane me resë kallami. Dëshemeja e objektit është shtruar me llustër çimento, si dhe dyert e dritaret janë prej druri.



13 7 8

Projekti parashikon rehabilitimin e pjesshëm të banesave, kryesisht të:

1. Ndërtimin e çatave të reja;
2. Ndërtimin e tavanëve të reja;
3. Dyer druri të brendshme e të jashtme;
4. Dritare duralumini;
5. Shtresa me pllaka dysHEMEJE;
6. Suvatime të brendshme dhe të jashtme;
7. Instalime elektrike;

Për çdo banesë janë hartuar planimetritë dhe preventivat përkatës të punimeve të parashikuara. Preventivi është hartuar në bazë të çmimeve të manualit të miratuar me VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

**HARTOI :**

**Ing. Eva ISMAILAJ**

